


# BESIMTARI

Gazetë mujore. Botues: Shoqata Bamirëse Islame Shkodër  
Viti I i botimit, MAJ 2008 Nr. 13. Çmimi 20 lekë.  
www.gazetabesimtari.com; e-mail: gazetabesimtari@yahoo.it

Kryeredaktor Selim Gokaj



## BOTOHET ROMANI RACIST I EKSTREMISTIT ORTODOKS BEN KIÇO BLUSHIT

Pa u larguar mire kryeministri turk nga Shqipëria, i cili bëri një vizitë të suksesshme dhe që u pasua me një pritje madhështore nga qeveria shqiptare, në libraritë të Tiranës dhe pastaj në të gjithë Shqipërinë vërshoi romani i Ben Kiço Blushit i cili në mënyrë të rrufeshme u bë libri i ditës, duke pasë një mbështetje të hapur dhe pa rezerva nga mediat shqiptare dhe veçanarisht nga politika shqiptare, e cila nxitoi të pozonte në media me figura të thekura antiislame si: Edvin Rama, që është betuar se xhami të madhe për muslimanët nuk do të ketë në Tiranë., Alfred Moisiu, një i hebre i kristianizuar që në Londër u betua, kur ishte presiden, para diplomacisë evropjane se shqiptarët nuk janë muslimanë, por kanë një shtresë milimetrike muslimanizmi që lehtë mund t'u hiqet, për të vazhduar pastaj me Sabri Godo e me Godo të tjerë që, kur është fjala për t'u rrallitë në një ceremoni, apo prezantin kundër identitetit të muslimanëve dhe kur sulmohen haptazi muslimanët, shtynjë nëri tjetrin për të dale në plan të pare që mediat t'u bëjnë sa më shumë reklamë këtyre figurave politike dhe të artit të cilat duket se "e marrin bukën në një dyqan". Publiciteti i rrufeshëm, që pasoi daljen e romanit të Ben Kiço Blushit, nuk kishte të bënte shumë me nivelin i lartë artistik që duhet të karakterizojë një vepër letrare, por kishte të bënte me mesazhin që përcillte, mesazh ky që, duke shfrytëzuar një vello historike, ngriti një stuhi antiislame në këmbë duke na bërë të dyshojmë se Blushi i Vogël duhet të ketë pasur edhe asistencë për t'ua sjellë në dorë shqiptarve këtë kolere që mund të sjellë vetëm urrejtje dhe pasoja që nuk mund të kalojnë me autokritika hpokrite dhe mashtruese nga autori dhe recensuesi i tij, duke u shtuar edhe botuesin e librit, përkatësisht Piro Misha dhe Fatmir Toçi me shtëpinë e tij botuese Toena, figura këto të njohura me precedent të theksuar si ekstremistë antimuslimanë, të njohur tashmë



publikisht. Thuhet se janë shitur deri tashti 5000 kopje dhe fitimi i Blushit të vogël ka kapur miliona duke ia rritur pasurinë që, për hr të vërtetës, atij nuk i mungon aq shumë. Por, as atij që e shkroi, as atyre që e mbështetën në të gjitha pistat: ekonomike, politike, fetare, diplomatike, në prapaskenë, larg dhe pranë Shqipërisë, nuk i intereson shumë fitimi i parave. Ata janë vetëm të interesuar të bëjnë publike tezat e tyre të rrezikshme dhe të shtrmbëruara historikisht, që kanë në qendër denigrimin e muslimanëve dhe nëpërkëmbjen e fesë islame, duke u bërë atyre një portret të rremë për ta shitur si të vërtetë. Rreziku i këtij botimi qëndron tek fakti se vetë botuesi, vetë autori, vetë prapavija e tyre e dine se ato që u serviren lexuesit në këtë roman nuk janë të vërteta. Por, ata janë të interesuar që të bëjnë diversion përmes mashtrimeve historike për të penalizuar një epokë 500 vjeçare, kur Perëndoria Osmani e kishte shtrirë sundimin e saj edhe në Shqipëri, ku masa e madhe e shqiptarve e quajten të favorshme dhe mikluase për karakterin e tyre dhe situatën politike të kohës, që të kon-

vertoheshin masivisht në muslimanë duke gjetur vehten të rehatuar mrenda fesë islame. Dilemës se a u konvertuan me shtëpi, apo me degën e ullirit, romani i Blushit të vogël këmbëngul tek shpata, në një kohë që argumentet janë se ishte një kthim paqësor i shqiptarve në muslimanë, sepse ndryshe ato pika, që mbeten të pa konvertuara, nuk do të bënin përjashtin. Arsytimi se ato i mbeten besnikë fesë së të parve dhe se ata ishin shqiptarët me besnikë, është një prallë qesharake që mund t'u treguhet budallejve në një natë dimri. Duket se Blushi të vogël e shumë Blushëve të tjerë, kthimi i shqiptarve në muslimanë i ka bërë që të kalojnë netë pa gjumë dhe në këto netë të rënda ata mbushin dosje kundër muslimanëve për t'ua hapur here pas here, si dikur diktatura, të cilën e paten "mëmë e atë" T'u bësh një portret të turpshëm muslimanëve me tipare vrasësish, mashtruesish, imoralësh, shkatërruesish dhe të krishterët t'i vendosësh në piadestal, do të thotë se ke marrë përsipër të realizosh një mision që lartëson një stivë me dru e cila pret një shkrepse për t'u ndezur, duke harruar kjo skortë

antimuslimane se zjarri mund t'i kalojë parashkikimet e tyre dhe ata mund ta shohin vehte në mes të tij nga edhe nuk mund të dalin. Kurrë nuk ka pasë luftë fetare në Shqipëri dhe aq më tepër që muslimanët të kenë qenë promotorët e saj. Nuk kemi takuar në media, as në botime të ndryshme sekuenca ku t'i thuhet fesë islame "Kolerë", siç e portretizon fenë Islame ekstremisti i çmendur ortodoks, Ben Kiço Blushi. Ne nuk shohim as gjurmë, as shenja tolerance në raman, por aty zien një lëmsh i zjarrtë urrejtjeje për pjesën dërmuese të popullsisë shqiptare, muslimanët, sepse edhe ateistët, përballë këtyre akuzave të mbushura me urrejtje, dalin nga pozicioni i tyre për t'u kundërvënë këtyre tezave të rrezikshme që vetëm re tëzeza sjellin në qiellin e shqiptarve siç ishte prononcimi mediatik i Shpëtim Nazarkos. Shqiptarët e ndershëm, që duan të jetojnë në paqë me njëri tjetrin, nuk mund të jenë dakort me helmin që romani përpiqet t'ua hedhë atyre në fytyrë. Dakort mund të jenë vetëm individë dhe segmente të caktuara që kryejnë misione antiislame në Shqipëri me urdhër, ose pa urdhër, ku spikasin një lukuni analistësh dhe politikanësh. Ndërsa muslimanët, përmes shoqatave të tyre e demaskuan këtë trakt antiislam që qarqe ekstremiste antiislame e hodhën në qarkullim Pjesa më e madhe e mediat të shkruara dhe vizive e çensuruan në mënyrën më të paturpshme deklaraten e shoqatave muslimane duke na bindur se mediat shqiptare mund të jenë pjesë e atij skenari që i dha dritën jeshile botimit të një romani të tillë që e shton mjegullën e Shqipëri dhe militont për të ndezë sherre në mes të shqiptarve. Mendojmë se edhe institucionet islame të të gjitha niveleve e kanë obligim që të mbajnë qëndrim dhe të ndalin këtë genocid mediatik spiralja e të cilit nuk ka të ndalur kundër muslimanëve dhe fesë islame në Shqipëri.

Selim Gokaj

**Ben Kiço Blushi**  
dhe ideologjia urrejtënxitëse e ortodoksisë  
OLSI JAZEXHI

**"KËSHILLA DJALLI"**  
...mikun bëjeni armik  
ABDI BALETA

fq. 2

fq. 3

**INVESTIM MADHESHTOR I SHOQATES TURKE V.H.K. ISTANBUL NE  
MEDRESENE E DJEMVE NE SHKODER**

fq. 4

**FMSH dhe shoqatat muslimane, indinjohen nga islamofobia  
dhe racizmi i Ben Blushit**

fq. 5

**Feja në shoqërinë bashkëkohore**  
ROALD A. HYSA

fq. 6

**SAHABET E RESULTIT (A.S.)**  
BURHAN FILI

fq. 6

# Ben Kiço Blushi dhe ideologjia urrejtenxënëse e ortodoksisë

Olsi Jazexhi

Romanit më të fundëm të Ben Kiço Blushit, 'Të jetosh në një ishull' i është dhënë shumë publicitet në mediat shqiptare. Shumë njerëz më të cilët kam folur për këtë roman, me çfarë kanë dëgjuar nga mediat, thonë që është një roman i mirë që flet për tolerancën fetare në Shqipëri, pse kështu kanë folur televizionet, kliente të Partisë Socialiste. Mbi mirësinë e librit të Ben Blushit foli edhe botuesi dhe miku i familjes Blushi, Fatmir Toçi, i cili në kapakun e prapëm të librit thotë që romani 'përpiqet të tregojë se si shoqëria shqiptare e përsosi instrumentin e bashkëjetesës fetare për t'i mbijetuar asimilimit dhe rrebesheve të kohës.' Kur fjalë të këtylla dalin nga një person si Fatmir Toçi i cili në një seri rastesh ka sulmuar muslimanët shqiptarë për librat që ata botojnë dhe ka kërkuar censurimin e tyre si në kohë të Partisë së Punës, unë, i nxitur nga dëshira e mirë për të kuptuar sesi është e mundur, që djali i Kiço Blushit, i islamofobit më të egër në Shqipëri, i cili hoxhallarët e Shqipërisë i ka quajtur xhambazë kuajsh, mund të shkruaj një roman që flet për bashkëjetesën fetare në Shqipëri, porosita nga Italia që të më blejnë këtë roman. Ishte një habi për mua që një njeri racist dhe islamofob si Beni i Kiços së Blushëve i cili në tetor të vitit 2006 i lë fyer muslimanët e Shqipërisë nga podiumi i parlamentit shqiptar, të mund të ndërroje pllakë brenda natës dhe në vend të urrëjtjes dhe racizmit islamofobit, të prodhojë një roman që flet për tolerancë.

Librin, të cilin porosita nga Tirana, e mora para dy ditësh dhe e lexova me një frymë. Libri i Benit, që ka 408 faqe, i dedikohet në faqen e 5të të tij Eva Bratit – Blushi, gruas së Benit e cila u akuzua disa vite më parë si përfutuese e pandershme e 250 milion lekëve të taksapaguesëve shqiptarë me 12 tendera të Albtransportit në kompaninë familjare të familjes Blushi. Duke parë që ky libër i dedikohet një personi të përfolur për korrupsion, që në faqen e parë të librit nënqesha me vete dhe thashë hajde tolerancë fetare që duhet të ketë këtu brenda.

Romani i Ben Blushit nis në një fshat, diku në jug të Shqipërisë. Beni ndoshta e ka imagjinuar romanin në fshatin e tij në Kolonjë. Në roman tregohet sesi një i krishterë vendos që një ditë prej ditësh të shekullit të 18-të të bëhet musliman. Arsyeja pse personi do të bëhet musliman, sipas Ben Blushi, është teoria e vjetër greko-sërbe kundër shqiptarëve, e cila islamizimin e shqiptarëve nuk ia dedikon triumfit teologjik të Islamit ndaj Krishtërit, por dhunës turke, taksave turke dhe muslimanët e islamizuar tregohen si servilë dhe njerëz frikacakë. Ben Blushi fut në gojën e të krishterit, që bëhet musliman, debate të ndryshme që ky bën për islam. Ben Blushi islamit e quan fe të dhunës. Kuranin libër të ndalimit dhe jo të lejimit. Muhamedit e akuzon sikur ai ka shkruar Kurandin edhe pse ai nuk dinte shkrim e këndim (fq. 9). Lëshohet, që muslimanët japin, ky e quan varfërim të njeriut (fq. 12), Islamit e tregon si një stuhi rëre që ofron dhe mbyl liritë e njerëzimit.

Kur Ibrahim bëhet musliman, Ben Blushi mbledh të krishterët e katundit të Kolonjës të cilët Islamit e quajnë kolerë që ka një mijë vjet që përhapet me majën e shpatës, ndërsa njerëzit që pranojnë mesazhin e Zotit, i quan Judë (fq. 23). Por ndërsa shqip-

tarët muslimanë janë judë dhe tradhëtarë, turqit Ben Blushi i tregon si ujqër të cilët, pasi shumëohen vrasin njëri tjetrin (fq. 25).

Turqit janë aq mizorë, sa ata i bëjnë edhe grekët e ishullit të Mitelenit mizorë, pasi këta rrojnë nën robërinë turke (fq.84). Turqit, në romanin e Benit, sjellin edhe kolerë me vete, kur ata pinë ujë në çesmën e fshatit (fq. 118). Këtë krahasim të turqve me ujqërit unë e kam gjetur në Mein Kampf-in e Hitlerit, ku ai i krahason çifutët me ujqërit të cilët kur shumëohen shumë hanë njëri tjetrin. Unë nuk e di se ku e mësoi Ben Blushi këtë krahasim të turqve me ujqërit, por di se Beni, ashtu si edhe i ati, janë anti-muslimanë të thekur. Në roman, personazhet e Ben Blushit tregojnë se dervishët, që predikonin islamit në Shqipëri, ishin përdhunues grashë (fq. 26), Ibrahimin, i cili bëhet musliman, të krishterët e thërrasin 'Ibrahim o derr, Muhamedi të pret në ferr' dhe ofendime të tjera kundër Profetit të islamit (fq. 33 - 35).

Por, ndërsa Ibrahim, personazhi kryesor i romanit të Benit është bërë musliman syni, Ben Blushi tregon që Ali Pashai është prototipi më i qartë i muslimanit shqiptar, i cili, sipas Benit, është bektashi, dhe si pasojë është hajdut, rrufian, njeri që ia ka me hile Zotit, kriminel, pedofil, kusar, përdhunues grashë dhe njeri i pabesë (fq. 44 - 52). Ali Pashain, i cili qeveriste grekët në Janinë, Ben Blushi e tregon si një mostër seksuale që kishte, jo vetëm femra në harem që e perdorte si bordell, por kishte edhe një bordell special me djem të rinjë. (fq. 325). Ndërsa operacionet anti-terroriste, që Ali Pasha bëri kundër banditëve grekë dhe suliotë, Ben Blushi i tregon si aksione kriminale dhe të pabesa nga shqiptarët muslimanë kundër suliotëve ortodoksë, që Beni, nga hajdutë dhe vrasës, i bën heronjë.

Procesin e islamizimit të shqiptarëve Ben Blushi e quan tradhëti ndaj krishtërit, pasojë e taksës së gjakut, xhizjes antikristiane, pengmarrjes nga turqit, dhunës që muslimanët shqiptarë ju bëjnë të krishterëve në Shkodër, Vlorë, Berat, Korçë, Janinë dhe Elbasan. Në Shqipërinë muslimane të Ben Blushit, kaurët terrorizohen nga muslimanët shqiptarë, të cilët grabisin toka, gra nga të krishterët, siç kanë mësuar nga Kalifi Umar (fq. 102 - 103). Muslimanë, në romanin e Benit bëhen edhe të krishterët e pabesë, që duan ti vjedhin babait tokën e tyre me ndihmën turke (fq. 111).

Herojtë e Ben Blushit në roman janë vllahët e Voskopojës. Personazhi kryesor i romanit është një grek bizantin me emrin Arianit. Këto Komnenët, të cilët të gjithë i njohin që historikisht janë grekë dhe shqiptarëvrasës. Por në roman shiten për shqiptarë në Voskopojë. Në bisedat, që Komneni bën me hajdutin, Ali Pashë Tepelena, heroit ortodoksi romanit sulmon islamit, shqiptarët muslimanë dhe mbron ortodoksinë dhe i tregon ortodoksët si herojtë e shqiptarisë. Duke ditur mllëfin që greko-ortodoksët kanë me Skënderbeun si hero katólik, Ben Blushi sulmon me gojën e Arianitit Skënderbeun që e quan turk, musliman, të pabesë, hileqar, njeri që i bën pabesira Arianitit dhe një njeri pa ndërgjegje, pasi ishte edukuar si musliman, njeri djallëzor për shkak të edukatës turke që kishte marrë. Por, njeri i keq në romanin Për Ben Blushin, heroit i tij, Arianiti është hero i krishtërit i cili thotë se nuk ka dallim nëse jemi shqiptarë, serbë apo grekë. Rëndësia ka që të luftojmë me flamurin e krishtërit, ku-

ndër Islamit që ai e quan një përbindësh më trup në Azi që vendin e ka në Azi. Ndërsa Islami i përket Azisë, Krishtërimi është një farë që nuk mund të mbijë në Azi (fq. 82). Heronjtë e Ben Blushit thonë që Shqipëria është vend i vogël për shumë fe, gjë që nënkupton se në këtë vend nuk ka vend për muslimanët (fq. 93).

Heroi i Benit lufton për të mbrojtur Kretën greke, Greqinë, Voskopojën dhe do të ndërtojë Perandorinë Bizantine me themel pan-ortodoksinë greke dhe çati Evropën (fq. 66 - 68). Arianiti Komneni është në dashuri të madhe edhe me serbët të cilët, me Gjergj Brankoviçin, bëjnë komplete për të marrë pushtetin në Kosovë. Muslimani shqiptar, që Arianiti takon në Stamboll, është Patrona Halili të cilin autori e tregon që është Lab. Dhe këta lebërit tregohen si hajdutë, vrasës, barbarë dhe tmerr i Stambollit (fq. 72 - 76).

Por, qendra e qytetërimit, që Ben Blushi e quan shqiptare është Voskopoja e vllaho-grekeve, Vllahët besojnë se Voskopoja është tokë e shenjtë e tyre, të cilën e shkatërruan shqiptarët muslimanë. Ndërsa serbët, Kosovën shqiptare e masakruan dhe e dogjën për 100 vite me radhë, falë besimit të tyre të marrë se Kosova është një Jeruzalem serb, voskopjarizmi vllah është edhe me i rrezikshëm pse ai cënon sigurinë kombëtare në Shqipëri, pasi vllahët duan të bëjnë një shtet brenda shtetit. Kush ka lexuar gazetën FRATRIA, që botojnë vllahët e Tiranës me Nasho Jorgaqin dhe Vangjel Shundin, do të shohin që vllahët e Tiranës botojnë aty poezi dhe shkrime ku pretendojnë që shqiptarët kanë qenë barbarë dhe vetëm vllahët e Voskopojës kanë patur qytetërim në Shqipëri. Këtë gjë synon të tregojë edhe Ben Blushi në romanin e tij. Beni e tregon katundin vllaho-grek të Voskopojës, sikur të mos ketë qenë një vendstrehim çobenësh hajdutër që jetonin me kuaj dhe me gomerë duke transportuar mallrat e muslimanëve shqiptarë, por sikur të ishte një El Dorado vllaho-ortodokse. Në roman Ben Blushi tregon që Voskopoja kërcënohet nga bandat muslimane të Korçës dhe Beratit. Muslimanët e Shqipërisë së Jugut, që nga Skrapari, Vlora, Korça dhe Berati, Beni i tregon si barbarë. Ndërsa vllahët, të cilët në Shqipërinë Osmane kanë patur statusin e evgjinit dhe rronin në gjendje gjysëm të egër, Beni i tregon sikur të ishin britanikë. Kapitulli 23 i romanit të Ben Blushit e tregon Voskopojën sikur të ishte një parajsë e cila ishte kështu vetëm nga që nuk kishte musliman. Kur erdhën muslimanët, Ben Blushi rrëfen që ata bënë hatanë, duke vlarë, kërcënuar, bërë banda të armatosura. Muslimanët, që vinë në Voskopojë nga Korça, Skrapari, Berati, Elbasani dhe zonat përreth, ishin jetimë, çobenë, të papunë, dembelë që rrëmbejnë dhe vrasin (fq. 211 - 214).

Në Voskopojë, sipas Blushit, kishte një udhëheqës që quhej Marin Kurilla i cili kërkoi që të hapi një luftë shqiptaro-vllahë duke sulmuar Korçën, Janinën, Beratit dhe Elbasanin dhe të vendosë hegemoninë vllahë në Shqipëri. Por, si pasojë e mosmobilizimit vllah, hajdutët shqiptarë muslimanë triumfojnë. Marini i fut këta në burg, por më pas vritet prej tyre. Muslimanët e varfër dhe të paditur që janë kthyer në Islam dhe kanë ardhur nga malet dhe fushat, tregohet që vinë në Voskopojë për t'u civilizuar (fq.216-228). Por, pasi vritet Marin Kurilla, pushtetin në Voskopojë e merr një tjetër vllah me emrin Isak. Ky i

bind kaurët e Voskopojës se Voskopoja është një ishull i krishterë dhe këta nuk e mbrojnë dot me luftë. Isaku i këshillon kaurët e Voskopojës që tua marrin fëmijët muslimanëve, t'i shkollojnë dhe t'ua hanë kokën me të butë duke i bërë ushtarë të tyre që të mbrojnë kishat. Muslimanët janë të egër, të hutuar dhe të uritur. Shqiptarët bëhen muslimanë, sipas Isakut, pse shpresojnë që Islami do ju japi çka ata nuk kanë.

Në këtë kapitull Ben Blushi sulmon edhe profetin Muhamedit të cili e portretizon në mënyrë perverse me disa vizatime që janë bërë në muret e një kishë, ku ai tregohet në pozicione perverse me gra të ndryshme. Me profetin Muhamedit tallen edhe gratë vllahë të Voskopojës të cilat bëjnë ironi dhe pyesin si i mban ai gjithë ato gra (fq. 238 - 240). Gratë vllahë, të cilat historikisht u kanë qenë trajtuar si jevga nëpër Shqipëri, Beni i tregon sikur të ishin zonja, ndërsa muslimanet shqiptare i tregon sikur të ishin femra të paditura dhe të egra. Në një vend të librit Beni e bën profetin Muhamedit evgjit dhe muslimanët i barazon me jevgjit, kur thotë që një fshat pa muslimanë dhe pa jevgji do të ishte monoton (fq. 357 - 358).

Ben Blushi hoxhën që ju vjen në Voskopojë muslimanëve dhe i mobilizon kundër tiranisë vllahë, e tregon si një injorant dhe prapanik. Priftërijtë pan-ortodoksë të Ben Blushit, Metodi dhe Mihali, të cilët Beni i pikturon si Shën Methodhiusin dhe Shën Cirilin bizantinë, inspirojnë personazhet e librit të Benit me tregimet e tyre për Voskopojën ku i nxisin fëmijët e vegjël që të vënë shalle të kuq në qafë, tamam siç bënte Ben Blushi kur ishte debatik në kohën e PPSH-së, Ben Blushi romanin e tij e mbyll në Kretë, ku vajza e heroit të tij, Arianiti Komnenit, Sara, shkon në ishullin grek, ku takohet me vllahun Isak dhe viziton varrin e të atit të saj, Arianitit, i cili ka shkruar që të vdes në ishull ku disa vite më parë kishin vdekur 11 vllaho-ortodoksë të tjerë në mbrojtje të Greqisë dhe krishtërit kundër turqve. Romani i Ben Blushit mbyllet me disa fjali melankolike nga personazhet e tij vllaho-ortodoksë ku ata thonë se në Voskopojë ne mendonim do t'i mësonim muslimanët të jetonin si ne (fq. 403). Ama personazhet vllaho-greke të Ben Blushit dështojnë që ti mësojnë muslimanët shqiptarë që të jetojnë si grekët Qyteti ku Ben Blushi jeton sot është e ndërtuar nga pashallarët muslimanë. Ky roman diskrediton botuesin e tij, Fatmir Toçi, Ky roman tregon rrezikun që i kanoset sot Shqipërisë nga politikanë si: Ben Blushi apo Ledia Shamku Shkreli të cilët me gjithë fundamentalizmin e tyre të egër kundër muslimanëve të Shqipërisë vazhdojnë të parazitohen në kurriç të taksapaguesëve muslimanë shqiptarë ndërsa që janë në krye të Partisë Socialiste, ngaku çenojnë tolerancën fetare që ne muslimanët i kemi imponuar Shqipërisë. Romani 'Të jetosh në Ishull' i Ben Kiço Blushit duhet të lexohet nga të gjithë shqiptarët muslimanë, ateistë dhe patriotë, për të kuptuar kërcënimin që sot i vjen Shqipërisë nga fundamentalistët ortodoksë me prapavijë të rrezikshme politike, siç është Ben Blushi që është pjesë i kupolës më të lartë të Partisë Socialiste e cila, kur të vijë në pushtet, pa tjetër që do të ketë në stafin e qeverisë së saj Ben Blushin dhe Blushët të tjerë që, platformën e këij romani, do të bëjnë përpjekje ta hedhin nesër në terrenin e Shqipërisë.

# “KËSHILLA DJALLI” ...mikun bëjeni armik

Abdi Baleta

**N**ga “shkrimet e shenjta” kemi mësuar se “prindërit e njerëzimit”, Adami dhe Eva, “mëkatin e parë” e bënë të nxitur nga “këshilla e Djallit”. Mëkatet qysh nga ajo kohë vazhdojnë pa mbarim. Po ashtu “këshillat e Djallit” nuk kanë të pushuar. Dikur kureshtjen prej fëmije për të ditur se ku rri Djalli të rriturit na e shuanin me fjalët “ka hyrë në barkun e insanit (njeriut)”. Tani që jemi të rritur e kuptojmë se Djalli në barkun e insanit nuk ka çfarë bën, por nuk mund të themi se në mendjen e njeriut ai nuk gjen vend.

Nga shkrimet njerëzore kemi mësuar se ka shkrimtarë, studiues, shkruer me zanate nga më të ndryshmit që zbulojnë e propagandojnë se “mëkati i parë” historik i shqiptarëve është pranimit masiv i fesë myslimane dhe ndëshkimi më i rëndë e fatkeqësia më madhe për ta mbetet përfshirja e tyre disa shekuj në gjirin e Perandorisë mesjetare Osmane. Në librin e vogël por me përmbajtje të ngjeshur të Rexhep Hoxhës “Nuk është ashtu” (Gjakovë 1996) u është bërë një kritikë e rreptë dhe e argumentuar mirë tezave të akademikut Zef Mirdita, të Engjëlli Sedajt e të shkrimtarit Ismail Kadare mbi këtë “mëkatin e parë” historik të shqiptarëve dhe hidhen poshtë këshillat e thirrjet e tyre e të disa të tjerëve për një revanshizëm antiosman e antimysliman në kohën tonë, duke braktisur Islamin e përqaftuar masivisht katolicizmin.

Rreth temës së revanshizmit antiosman e antimysliman për të shpëtuar nga “mëkati fillestar” janë bërë mjaft polemika gjatë 18 viteve të fundit. Më është dashur edhe mua të përfshihem në këto polemika, sidomos në replikat ndaj Kiço Blushit në vitin 1992, ndaj Ismail Kadaresë në vazhdimësi, ndaj një shkrimi të Neshat Tozajt në “ZP” më 10 Janar 1995 nën titullin “Shqipëria një depo municioni islamik?” etj. Ky

titull ishte huazuar nga revista franceze “Historia jonë” dhe nga një pankartë me përmasa 40 x 50 centimetra të vendosur nëpër muret e Parisit. Aq përshtypje kishin bërë kjo parullë tek autori i shkrimit të “ZP-së” sa në këtë gazetë propozohet që pa humbur asnjë minutë kohë të bëhej një regjistrim popullsi në Shqipëri që shqiptarët të shkruheshin si të krishterë.

Nën efektet e parullës pariziane është kurdisur një propagandë e shfrenuar e pandërprerë në Shqipëri për të fryrë rrezikun e fundamentalizmit e të terrorizmit islamik për shqiptarët e tërë Europën nga territori shqiptar. Në vitin 2001 në këtë frymë doli një libër i tërë i titulluar “Nacional-islamizmi shqiptar...”. Në vitin 2005 vetë ish-kryetari i shtetit shqiptar shkoi e mbajti një ligjëratë në Universitetin e Oksfordit (Angli) si pendesë për “mëkatin fillestar” të shqiptarëve dhe si premtime se do të punohet për shlyerjen e këtij mëkati në Shqipëri e për rikthim të shqiptarëve në “kohët e arta skënderbegiane”, pra në gjendjen paraosmane. Ligjëratë në Oksford dukej si një dekret presidencial për të zbatuar porosinë që jepte “ZP” në vitin 1995.

Kështu në andrrallat e tyre të përditëshme shqiptarët janë ndeshur shpesh me

“këshilla e punë Djalli” si thirrjet për revanshizëm antiosman e “rikonkistë katolike”. Por nuk janë ndër të mundur e të humbur se Perëndia ka dhënë mendjen e arsyen, vullnetin e vendosmërinë për të mos rënë pre e qoftëlargut, sepse çon dhe engjëj të drejtojnë njerëzit nga e mbara. Nuk kanë munguar asnjëherë fjalët dhe këshillat e mira të njerëzve të arsyeshëm e të ditur për trajtimin e problemeve të tilla. Shqiptarët krahas përkujdesjes hyjnore vazhdojnë të marrin mesazhe të urtë njerëzore, si për shembull ata që na ka dhënë historiani zviceran Aleksandër Lamber në intervistën e tij botuar në “Panorama” më 30 Nëntor dhe 1 Dhjetor 2007 nën titujt shumë domethënës “Europa sabotoi historinë tuaj në shekullin XIX kur Ilirinë e quajti Ballkan” dhe “Aleatët ia lanë Lindjes Shqipërinë edhe pse e dinin se s’ishit sllavë”. Lamber shpreh me gjuhën e tij të thjeshtë njerëzore atë që shumica e shqiptarëve e quajnë “mrekulli hyjnore” lidhur me bombardimet e NATO-s mbi Serbi për të shpëtuar Kosovën në vitin 1999: “Pas Luftës së Ftohtë, Europa nuk ka qenë në gjendje të ndalojë gjenocidet dhe spastrimet etnike në kontinentin e vet. Po të mos kishin ndërhyrë më në fund Shtetet e Bashkuara për të ndaluar masakrat në Bosnje e Kosovë, asgjë nuk do ta kishte ndaluar regjimin e Milosheviçit të çonte deri në fund gjenocidin që bënte kundër popullsisë myslimane të Ballkanit”.

Megjithatë edhe pasi vijën mesazhe të tillë ndodh që të gjejmë...

“Këshilla Djalli” edhe ... në një shkrim të Engjëllit

“Turqia i ka borxhe historike Kosovës”, është titulli i këtij shkrimi të botuar në të përditëshmen “Telegraf” më 5 janar 2008, sapo rinisën punën gazetat pas pushimeve festive (ribotuar më pas edhe në “Ndryshe”, e mbase në ndonjë gazetë tjetër). Siç ishte krejt e natyrshme dhe e kuptueshme gazetat gjatë gjithë vitit që sapo u mbyll (2007), sidomos gjatë periudhës së bisedimeve shtesë 120 ditore për përcaktimin e statusit të Kosovës, kanë qenë të përqëndruara në intrigat e komplotet e politikës thellësisht armiqësore serbo-ruse për të zvarritur, penguar e sabotuar procesin diplomatik ndërkombëtar për njohjen e pavarësisë së Kosovës.

Nuk pritej që qysh në ditët e para të janarit 2008 në gazetat e Tiranës të shfaqej një shkrim që shtrembëron historinë dhe realitetin e zhvillimeve për çështjen e Kosovës, në të cilin si armiku më i madh paraqitet miku më i mirë dhe më i sinqertë i shqiptarëve, kombi e shteti turk. Por pikërisht kjo ka ndodhur me shkrimin e Engjëlli Koliqit “Turqia i ka borxhe historike Kosovës”. Nuk mund të themi me siguri nëse gazetat që e kanë botuar kanë pasur një synim të tillë, apo e kanë hedhur në publik pa e vrarë shumë mendjen për përmbajtjen dhe mesazhet e mbrapshtë të kësaj “kartolinë urim-provokimi”, jo vetëm ndaj kombit e shtetit mik turk, por edhe ndaj gjithë shqiptarëve që çmojnë e përshëndesin miqësinë tradicionale e vëllazërore shqiptaro-turke.

Pas një sërë interpretimesh të mbrapshtë për ngjarjet historike, autori me emrin Engjëlli ka rreshtuar disa direktiva që

tigëllojnë si “këshilla Djalli” për organet udhëheqëse të Kosovës, të cilët pritet të fillojnë së shpejti funksionet e qeverisjes së pavarur të shtetit sovran, të njohur ndërkombëtarisht. Është këshillë e keqe të shkruash: “Duke pasur parasysh të gjitha këto që thamë më lart, e sidomos marrëveshjet famëkëqija që Perandoria Osmane e më vonë Turqia ka bërë me Rusinë dhe me ish-Jugosllavinë në dëm të shqiptarëve, institucionet shtetërore të Kosovës (Kuvendi, Qeveria dhe Presidenca) duhet të kërkojnë nga qeveria e Turqisë në Ankara, që me akt zyrtar t’i shpallë të pavlefshme respektivisht t’i anullojë këto marrëveshje dhe pëfundimisht të njohë identitetin kombëtar të miliona shqiptarëve që jetojnë në Turqi, duke u dhënë atyre të drejtat që u takojnë me konventa ndërkombëtare”. (“Telegraf” 5 janar 2008).

Në fakt këtu kemi të bëjmë me një provokim të hapur të dyfishtë: 1-kundër udhëheqësve dhe opinionit publik shqiptar të Kosovës, të cilëve u kërkohet të mos përqëndrojnë më tej vëmendjen në detyrën e tyre kryesore për përbalimin e ofensivës më të egër armiqësore antishqiptare nga politika e diplomacia serbo-ruse, por të hyjnë në sherre me Turqinë mike; 2-kundër udhëheqësve dhe opinionit publik të Turqisë që vazhdimisht kanë dëshmuar ndjenja të simpatisë më të sinqertë për shqiptarët dhe kanë mbështetur fuqimisht çështjen e Kosovës, duke i bezdisur ata sado pak me mesazhe të “mosmirënjohjes shqiptare” (lexo engjëllkoliqase).

Është veprim ngatërrestar t’u japësh udhëheqësve kosovarë “direktivën” politike që të hyjnë në “luftë diplomatike” me Turqinë pikërisht në kohën e përbaljes më të madhe dhe më të rreptë me dinakëritë e komplotet e diplomacisë ruse kundër pavarësisë së Kosovës, siç dëshmuar edhe fjalimet e serbit Tadiç e të rusit Çurkin në Këshillin e Sigurimit të OKB-së më 16 janar 2008, kur këmbëngulën se shpallja e njëanshme e pavarësisë së Kosovës qenka e pavlefshme dhe Serbia e Rusia kurrë nuk do ta njohin atë. Është jo vetëm paradoks, por dhe minim i luftës së vështirë që po bën Kosova në frontin diplomatik kur 10 ditë para këtyre deklaratave serbo-ruse të lëshohet në shtypin e Tiranës, qoftë dhe në formën e një shkrimi të rëndomtë pa vlerë direktiva që udhëheqja kosovare të hapë frontin e ri të luftës diplomatike kundër Turqisë si hakmarrje për “borxhet historike” që i paska kjo qysh nga koha e Perëndorisë Osmane! Çfardo problemesh që të kenë shqiptarët me kombe e shtete të tjerë, të mbetur nga historia apo të krijuar rishtas, fronti kryesor i luftës politike dhe diplomatike ku duhen përqëndruar të gjitha energjitë është ai përballë diplomacisë serbo-ruse për Kosovën. Këshillat për të hapur fronte te reja lufte diplomatike kundër vendesh e kombesh mike si Turqia që na kanë ndihmuar dhe po na ndihmojnë pa pushim të përballojmë trysnitë e fqinjëve sllavë e grekë, janë djallëzore dhe tradhtarë ndaj çështjes kombëtare shqiptare në tërësi.

Për ta pasur pamjen të qartë për miqësinë e Turqisë mjafton të kujtojmë suksesin e madh të vizitës së kryetares së Kuvendit të Shqipërisë, Jozefina Topallit, në Ankara në fund të vitit 2007, ku ajo shkoi të

kërkonte mbështetjen e Turqisë që edhe Konferenca e Vendeve Islamike të njohë menjëherë pas shpalljes pavarësinë e Kosovës. “Këshillat” e Koliqit tërthorazi janë një reagim negativ i mllëfosur kundër rezultateve të kësaj vizite. Ndërsa gazetë që i botuan ato si “kartolinë fyerjeje” ndaj Turqisë mike për vitin e ri 2008 kanë dëshmuar mungesë nuhatjeje politike, nëse nuk kanë pasur arsye tjetër më të papranueshme. Për ata që kanë marrë huqin e keq që punët e shtetit e të kombit shqiptar t’i vështrojnë vetëm nëpërmjet syzeve të fanatizmit fetar antimysliman, antiosman e antiturk duhet të përmendim se edhe Zonja Topalli, që gjeti në Turqi pritjen më të mirë dhe siguroi mbështetjen e fuqishme për shqiptarët, është e besimit katolik, sikurse Engjëlli Koliqi.

Të njëjtën gjë duhet ta themi edhe lidhur me vizitën e zonjës Topalli në krye të një delegacioni parlamentar në disa vendet myslimane të Gjirit Persik në mesin e muajit Janar 2008. Kjo vizitë duhet t’i ketë pezmatuar shumë ata që gjatë 16 vjetëve me radhë pas pranimit të Shqipërisë në Konferencën e vendeve Islamike si anëtare me të drejta të plota (në vitin 1992) nuk kanë lënë fyerjeje pa bërë kundër mbështetësve të këtij anëtarësimi. Po tani a do ta kenë të njëjtën paturpësi që edhe zonjat Jozefina Topalli e Valentina Leskaj t’i etiketojnë si fundamentaliste ekstremiste islamike, meqenëse bënë vizitë zyrtare në vendet arabe? Vizita e zonjës Topalli në vendet arabe duke pasur në delegacion edhe kryetaren e grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Leskaj, është një shuplakë e fortë për politikën pa mend të drejtuesve të kësaj partie që me gojën e ministres së tyre të jashtme, Arta Dade, vetëm pak kohë më parë bënë një zhurmë krejt të pahishme kundër vizitës së kryeministrit Berisha në Egjipt ku kishte shkuar të siguronte mbështetje diplomatike për Kosovën.

Politikanët, vëzhguesit e analistët shqiptarë e kanë për detyrë të sqarojnë sa më hollësisht opinionin publik shqiptar se kush është armiku real i tij, se nga vjen rreziku i vërtetë, nga kush duhet të ruhem, kujt duhet t’i kundërvihemi, jo të krijojnë konfuzion duke paraqitur mikun si armik dhe hasmin si dashamir të mundshëm. Gazetat shumëfaqëshe të Tiranës mund të bëjnë në këtë kohë një punë të mirë duke pasqyruar e shtjelluar më tej faktet e shumta konkrete dhe vlerësimet që përmban libri i ish-ambasadorit shqiptar në Moskë Shaqir Vukajt “Rusia dhe Kosova” (Tiranë 2007) për armiqësitë ruso-serbe ndaj shqiptarëve dhe të mos merren me shtrembërime historike e thirrje patetike për revanshizëm diplomatik antiosman e antiturk. Është absurde dhe provokuese që, edhe pas botimit të librit “Rusia e Kosova”, shkruer e botues shqiptarë të hiqen si të paditur (apo të mbeten të paditur) dhe t’i ofrojnë opinionit publik “vlerësime shejtani” e “këshilla djalli” si në shkrimin “Turqia i ka borxhe historike Kosovës”.

*Ky material sëbashku me atë të numrit të kaluar dhe në numrat në vazhdim janë botuar tek Gazeta Republika. Besimtari boton me leje të autorit.*

Redaksia

# INVESTIM MADHESHTOR I SHOQATES TURKE V.H.K. ISTANBUL NE MEDRESENE E DJEMVE NE SHKODER

Ditën e dielë , me datën 27 prill 2008 ,ne medrenë Haxhi Sheh Shamia në Shkodër u inagurua fillimi i punimeve për ndërtimin e kompleksin arsimor, investim i shoqates turke V.K.H. Istanbul i cili është një dhuratë madhështore për medrenë Haxhi Sheh Shamia dhe për qytetin e Shkodrës, sepse do të jetë një kompleks, sa fetar, aq edhe një rregullator që do t,i jape një pamje tjetër hyrjes së qytetit të Shkodrës. Në këtë inagurim ishin të ftuar miq të nderuar, duke filluar nga herarkia më e lartë e KMSH dhe duke vazhduar me përfaqësuesit më të lartë të pushtetit lokal si:prefekti, Maxhit Cungu, kryebashkiaku ,Lorenc Luka, kryetari i rrethit, Gjovalin Kolombi ,miq nga bashkësitë islame të Kosovës, Maqedonisë dhe Sanxhakut. Gjithashtu ishin të ftuar imamë të xhamiave ,banorë të lagjes xhabie dhe prindër e nxënës të medrezesë së vajzave dhe të djemve.Këtë aktivitet të rëndësishëm e hapi drejtori i medrezesë, Kujtim Dervishi i cili u uroi mirëseardhjen të ftuarve duke i lënë rrallën pastaj hafizit, Idriz Ceskin, i cili lexoi vargje nga Kur-ani i madhërishtëm.Pasi drejtori ,Kujtim Dervishi, kishte dhenë treguesit për këtë kompleks madhështor, Kryetari i KMSH ,Selim Muça dhe pas tij të ftuarit e tjerë të lartë vendosën nga një tulle në themelet e këtij kompleksi. Duanë për ndër-



timin e kësaj dhurate të shoqërisë turke V.K.H. Istanbul e bëri myftiu i Shkodrës, imam Ndrëçim Sulejmani. Përshendetën fillimin e këtyre punimeve Kryetari i KMSH, Selim Muça,kryebashkiaku ,Lorenc Luka, myftiu i Shkodrës, Ndrëçim Sulejmani dhe kryetari përgjithshëm i shoqatës turke V.K.H.Istambul, Arif Qerosi.

Në fund të këtij aktiviteti, duke respektuar traditën ,u bë edhe therja e kurbanit

Në një intervistë që bëmë me drejtorin e medrezesë ,Kujtim Dervishi, mësuam edhe historikun që pasoi inagurimin e këtij kompleksi mësimor.Ideja për një konvikt, si domozdoshmëri për medrenë ,daton në vitin 2005-2006 e cila u realizua me ardhjen në Shkodër të z. Nuri Topash i cili e përkrahu këtë ide

që koha tregoi se u bë realitet .Nga ata që tha drejtori, mësuam se kontributi i zotërinjve Shuajb Bashan , Lorenc Luka, myftiut, Ndrëçim Sulejmani dhe ingjinjerët Anol Dedja, Sirolan Zaja dhe Mysaret Myrtja ka qenë një ndihmesë, e cila krijoi lehtësira dhe mbarëvajtje në fillim e punimeve në këtë kompleks mësimor të medrezesë së djemve.Gjatë intervistës mësuam se konvikti do të jetë një ndërtesë me katër kate, ku kati i pare do të ketë salla kulturore, mediatike me paisje bashkohore dhe me kapacitet 350 vende,në një kohë që kati i dytë dhe i tretë do të jetë konvik me100 shtretër me të gjitha anekset përkatëse, ku spikasim zyra, dhoma, shërbimi, magazina dhe shërbim mjekësor. Kurse kati i katërt do të ketë një mence moderne ku mund të vendosen 400 persona

që mund të jenë konviktorë, ose të ftuar për raste nga më të ndryshmet. Me shumë vlerë ishte informacioni që morëm se në këtë kompleks do të jetë edhe një xhami madhështore me një hapësirë që do të pranojë deri në 400 persona per t,u falur, duke pasë edhe vende për avdes. Xhamia do të ketë edhe një minare madhështore të gjatë 25 metra e cila do ta kompletjë këtë xhami si një bukuri të rrallë në hyrje të qytetit të Shkodrës.I pyetur për vlerën e këtij kompleksi dhe sa do t,i shërbejë ai procesit mësimor- edukativ në medreze, drejtori, KujtimDervishi, theksoi se ai do të zgjidhë problemin cilësor në treguesit mësimor, edukativ, fetarë dhe shkencorë.Nga ana tjetër kompleksi, me konviktin e tij të ri, do të jetë garant për rritjen e numurit të nxënësve në medreze. Kompleksi do të ndikojë edhe në përmirësimin e higjenës në këtë hapësirë, problem që ka mbetur pa zgjidhje.Duke mbyllur intervistën me drejtorin e medrezesë, Kujtim Dervishi, mësuam se për të pranishmit në këtë ceremoni u shtrua një drekë nga organizatorët për të vazhduar në orën 20 me një koncert festiv nga një grup artistik miks i medrezesë së djemve dhe të vajzave.

Selim Gokaj  
Shkodër me 27 prill 2008

## DYNJAJA ËSHTË VENDI I SPROVAVE

Ai që beson që në këtë botë ka ardhur për t,u sprovuar,duhet të veprojë me kujdes shumë, sepse secili nga ne e di se kur një nxënës hyn në një provim ai nuk mund ta dijë se cila pyetje do t, i bjerë atij . Prandaj, për këtë arsye ai përgaditët për të gjithë lendën duke shpresuar gjithmonë se do të marrë shpërblimin për punën e bërë. Për ta ballafaquar besimdrejtin me atë që ai vepron në jetën e tij ne po ju kujtojmë një shembull. Një ditë takova një burrë që kishtë shkorurëzuar një grua me të cilën kishtë 4 fëmijë dhe po ky burrë po kërkonte prej meje ndihmë që ta martoja me një grua tjetër. Unë nuk i dhashë përgjigje, por në shtëpi i tregova gruas sime për këtë ngjarje e cila më tha se duhet të shkojmë t,i pajtojmë punë që e bëmë, anipse ishim 1000 klometra larg njeri tjetrit . Por, miku im nuk pranoi këshillën

tone.Kur po mbaja një bisedë fetare, një nga besimtarët që po ndiqte ligjëratën më ndërpreu duke më thënë se ishte habitur, kur kishtë marrë vesh se një plak po i shërbentë gruas së sëmure duke i bërë të gjitha shërbimet sepse gruan e kishtë të paralizuar. Në atë bisedë ishte prezent edhe ai miku im që kishtë ndarë gruan me 4 fëmijë, i cili u ngrit dhe iku ,sepse e ndjeu vehten keq nga se nuk e kishtë duruar gruan e vet dhe ishte nervozuar për diçka që edhe mund ta kishtë kaluar, duke parandaluar kështu edhe divorcin që kishtë sjellë për të gjithë këtë familje aq pasoja E tregova këtë ngjarje për të kujtuar se feja islame ka urdhëruar duke thenë qe grate në duart e burrave janë një amanet dhe ndaj këtyre duhet të jemi të sjellshëm dhe kush hidhërohet me grate nuk fiton ,por fiton ai që i duron grate. Grind-

jet në mes të burrit dhe të gruas nuk kanë pasoja vetëm për ato, por pasojat rriten ndaj fëmijve ,sidomos kur përplasjet bëhen në praninë e fëmijve.Përplasjet në mes të burrit dhe të gruas duhet të shmangen në sy të fëmijve, sepse prindërit janë pasqyrë për fëmijët e tyre dhe nesër ata do të bëhen pasqyrë për fëmijët e vet.Që të dihet vlera e ditës, duhet të dime së pari se çfarë është nata

Prandaj, mosbesimtari me besimtarin janë në një largësi të madhe fetare ndaj njëri- tjetrit.

Nga një mosbesimtar nuk priten sakrifica dhe durim në jetën bashkshortore ,sepse ai në këtë botë ka vendosur të plotësojë të gjithë tekat e tija ,duke përfunduar edhe tek ata epshore. Prandaj, në Perëndim, ku ateizmi është kthyer në një epidemi, rrallë ka njerëz që kanë mbetur me një martesë, aq sa mediat informoj-

në për 60% të fëmijve të lindur në mënyrë të paligjshme. Mosbesimtari nuk ka moral për t,u përcjellë të tjerëve, sepse ai kujdeset vetëm për vehten e vet dhe në këtë linjë grua-ja është larg kujdesit për burrin e vet, për vjehrrën dhe vjehrrin e vet. E kundërta ndodh me besimtarin i cili e di se Allahu xh.sh. i ka kujtuar :''Ata janë mbrojtje për ju dhe ju jeni mbrojtje për ata''Duke analizuar problemin në këtë linjë, bashkëshortët janë mburojë për njëri- tjetrin dhe mrojtje për njëri- tjetrin, sikur veshja e njeriut mbulon të metat e trupit.. Prandaj, kur familja është ndërtuar mbi moralin dhe normat e fesë islame, jetëgjatësia e saj nuk do të njohë kurrë ndërprerje.

Abdulkadir Haktanër  
Turqi

# Deklaratë:

## FMSH dhe shoqatat muslimane, indinjohen nga islamofobia dhe racizmi i Ben Blushit

Shoqatat Muslimane të Shqipërisë kanë përcjellë me keqardhje dhe indinjatë botimin e romanit të Ben Blushit "Të jetosh në ishull" dhe bujën mediatike me të cilën u shoqërua ai.

Ndonëse tinëzish në promovimin e tij libri u paraqit si një vepër që flet për tolerancën dhe bashkëjetesën fetare në vendin tonë, nga leximi i tekstit dhe komentet që janë bërë rreth tij në shtyp rezultojnë krejt e kundërta. I gjithë libri karakterizohet nga fryma e përbuzjes ndaj fesë Islame në veçanti, si dhe ndaj vlerave dhe simboleve të tërë kombit shqiptar në përgjithësi.

Së pari, vepra shfaq një mori të pavërtetash dhe pasaktësishë për fenë Islame duke dhënë kështu një imazh të deformuar saj. Në romanin libri i shenjtë i muslimanëve, Kurani, quhet libër i ndalimit. Aty thuhet se ai është shkruar nga vetë Muhamedi dhe nuk është revelatë (zbritje hyjnore). Libri shfaq gjithashtu paragjykimet për mjaft çështje fetare duke i keqinterpretuar ato si dhe duke i veshur Islamit parime dhe pikëpamje që nuk kanë të bëjnë me të.

Së dyti, vepra shfaq një mungesë të madhe etike, duke fyer vlerat humane, besimin dhe simbolet fetare. Autori tallet jo vetëm me disa prej praktikave dhe ritualeve të fesë Islame, por ai nuk ngurron të njollosë edhe vetë figurën e Profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të) duke e përshkruar atë me terma fyes.

Në këtë roman ofendohen në mënyrë të veçantë muslimanët shqiptarë, të cilët cilësohen si tradhtarë të krishterimit, dhunues të të krishterëve, barbarë, banditë, të paqytetëruar, përdhunues e të pabesë. Romani në fjalë është shumë shqetësues edhe për racizmin që ai shfaq për popuj dhe etni të tjera.

Së treti, vepra deformon historinë e popullit shqiptar, duke ofruar një perspektivë negative e cila cenon vlerat si dhe figurat historike simbol të tij.



Shoqatat muslimane të Shqipërisë gjykojnë se kjo vepër prodhon efekte negative dhe tejet provokuese në shoqërinë shqiptare. Ajo fyen në mënyrë të qëllimshme atë çka është më e shenjtë për një besimtar – fenë e tij, e duke nxitur kështu urrejtjen ndërmjet shtresave të popullsisë me fe të ndryshme, godet një nga vlerat më të spikatura të kulturës shpirtërore të shqiptarëve – bashkëjetesën në harmoni ndërmjet feve, ku muslimanët kanë pasur dhe kanë rol vendimtar.

Të ndërgjegjshëm për të drejtën kushtetuese të shprehjes së lirë si edhe për lirinë e krijimit artistik, theksojmë se nuk kemi të bëjmë thjesht me një vepër letrare të radhës, duke qenë se autori Ben Blushi nuk mund të gjykohej pandashmërisht nga pozicioni i tij qendror në jetën politike të vendit, pozicion ky i cili i siguron romanit vëmendjen maksimale të opinionit publik. Nënvizojmë gjithashtu se botëkuptimi i autorit në fjalë nuk mund të kuptohet ndaras pozicionit dhe botëkuptimit të tij

si politikan.

Autorit Ben Blushi, ndonëse ligjvënës i njëres prej dy forcave kryesore politike të vendit, Partisë Socialiste, i zgjedhur në parlamentin shqiptar me vota edhe të shumë muslimanëve, nuk i ka shkuar ndërmend se fryma që përçon romani i tij në mënyrë të dukshme kundërshton vlerat themelore të Kushtetutës së Shqipërisë, në preambulën e së cilës ndër të tjera deklarohet:

"Ne Populli i Shqipërisë, krenar dhe të vetëdijshëm për historinë tonë, me përgjegjësi për të ardhmen, me besim te Zotit... me vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik dhe social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, me frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare, me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe personalitetit njerëzor... për paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror, me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar..."

VENDOSIM KËTË KUSHTETUTË: ..."

Duam t'i kujtojmë z. Blushi dhe atyre që mund të jenë me një mendje me të se feja Islame është feja e pjesës më të madhe të shqiptarëve kudo që ata jetojnë, në Republikën e Shqipërisë, në trojet etnike si dhe në diasporë. Ajo është pranuar prej tyre pas një procesi të gjatë historik dhe tashmë është bërë një pjesë e rëndësishme e identitetit të tyre shpirtëror e kombëtar. E parë në këtë këndvështrim, çdo sulm ndaj fesë islame nuk mund të mos prekë vetë kombin shqiptar.

Shqetësimi ynë më i madh është se vepra si kjo e Ben Blushit furnizojnë me municion të bollshëm armiq të historikë të shqiptarëve. Pas arritjeve madhore të faktorit shqiptar, si realizimi i pavarësisë së Kosovës, pranimi i Shqipërisë në NATO dhe perspektiva e saj e qartë evropiane, qarqeve antishqiptare u ka mbetur tashmë vetëm një armë në dorë: t'i përçajë shqiptarët duke i ndërsyer ata kundër njeri-tjetrit. Kështu, duke helmuar klimën e bashkëjetesës fetare ndërmjet tyre i bëhet një shërbim i çmuar këtyre qarqeve.

Duke u ndjerë të fyer dhe të provokuar nga kjo vepër, shoqatat muslimane i bëjnë thirrje shoqërisë civile, opinionit publik shqiptar dhe atij ndërkombëtar, mediave dhe shtetit shqiptar si dhe kujtdo që ndjehet krenar për historinë dhe vlerat e popullit të vet, të distancohen nga teza e pikëpamjeve të tilla që krijojnë precedentë të dëmshëm për bashkëjetesën shoqërore dhe nxisin racizmin, islamofobinë dhe ksenofobinë në Shqipëri.

Do të ishte gjithashtu një detyrim etik për forcën politike ku autori militon, si dhe për anëtarët e tjerë të parlamentit shqiptar, të distancohen nga këto pikëpamje, të cilat kërcënojnë harmoninë e brendshme të shoqërisë sonë.

## LIBRI I TË BIRIT SI SHKRIMET E BABAIT

Menduar se deputeti i PS, Beni i vogël i Blushëve, të njohur si opozitë e ashpër antiislame që është edhe pasuri gjenetike e Kiço Blushit se e ka lënë të shkruarit artistik. Por nuk ndodhi kështu, sepse Ben Blushi pozon bukur në kopertinën e librit të titulluar "Të jetosh në ishull". Vetëm një detaj më pëlqeu i cili ishte në faqen bosh, diku nga mesi i librit, ku gjen të shkruar një përkushtim me germa shumë të vogla me të cilin i drejtohet më emër atij që i takon ky përkushtim që është ky roman i botuar. Azgjë tjetër të mençur nuk gjeta në faqet e këtij romani. Përkundrazi u zhgënjeva. Autori, përmes faqeve të librit, e fshih mllëfin e tij në konceptin fetar. Lexova faqen 13 dhe nuk munda të lexoj më gjatë, sepse në mendjen time filluan të dalin figura intelektualësh shqiptarë që kanë shkruar para tij mllëfe dhe sharje kundër besimit islam. Kemi 17 vjet që përballemi me këto krijesa të kultivuara në laboratorët e krimeve ndërfetare. Bota nuk e ka temperamentin e heronjve në fushën e besimit, por ajo menaxhon arritjet e këyre heronjve! Përse nuk ua mbush mendjen si një hero i kotësisë inkuzitori i madh dhe politikani i vogël Kadare? Po Maks Velo, ky mjeshër i madh i vijave të shtrembura, apo Piro Misha, Kastriot Myftaraj, Nexhat Tozaj

, Kiço Blushi dhe Ben Blushi? Janë në fak pak, por mund të formojnë një skuadër volejboli, por kurrë një skuadër që të përmbysë Shqipërinë me lojrat e tyre të fëlliqura me ngjyrë antishqiptare. Për një kohë, ata paten heshtur se ishte Abdi Baleta që ua pat mbyllur gojën me gazetën "Rimëkëmbja" Janë vetëm dy apo tri thënie në këtë roman që të irritojnë shumë; "Njoh shumë të tjerë që do të ishin bërë muslimanë, po të jetonin me regjimin e bagëtimeve", "Kur-ani është libër i ndalimit dhe jo i lejimit", "Islami është kolerë", "Miljona njerëz jetojnë në këtë epidemi", "Muhamedi e shkroi Kur-anin, megjithëse në moshën 40 vjeç nuk dinte shkrim dhe këndim. Një deklaram interesant i Blushit të vogël është, kur deklaroi se zgjohet herët si kafshët dhe nuk e ka të vështirë të falet. Faljet janë rituale njerëzore, por Ben Blushi ngjan me kafshët në regjimin e tij ditor, duke na detyruar të pyesim të atin se a do ta lejojë të bëjë një konvertim të tillë në kafshë i biri i tij, që po ecën në rrugën e të atit si antimusliman. Deklaratat që Ben Blushi bën në romanin e tij kundër muslimanëve dhe fesë islame janë mllëfe që nuk kanë shkak dhe po irritojnë muslimanët dhe ky irritim e bën autorin e romanit që të shqetësohet, sepse ai ka menduar se do ta hedhe lehtë lumin duke penali-

zuar muslimanët. Kur lindi Profeti Muhamedi, as, bota nuk kishte asnjë musliman dhe Profeti ishte misionar i Zotit, i cili përhapte me korrektesë të lartë fjalën e Zotit xh.sh. Sot Bota numëron mbi 1.5 miliard muslimanë që janë në këtë linjë fetare edhe nga vepra madhështore e Profetit, Muhamedit a.s.. Blushi mendon se njerëzit vrapojnë me sy mbyllur në rrugën e historisë së tyre rrugë që në fakt e bëjnë ata që nuk e duan Islamit si Ben Blushi me skortën e tij

Sot, për fat të keq dhe me qëllim të mrapshtë, shumë jomuslimanë e mendojnë islamit si fe që nxit dhunën, luftën dhe terrorizmin, mendime që janë bërë pjesë me rendësi e lajmeve që po i publikojnë mediat e huaja dhe ato shqiptare. Këto media antiislame kanë firmat e investitorëve të tyre të cilët duket se duan të nxisin mendime dhe veprime të gabuara.

Njerëzit duhet të jenë shumë të kujdesshëm, kur marrin informacione nga mediat duke i ballafaquar dhe duke i verifikuar këto informacione, sepse mund të bëjnë viktime të mashtremeve dhe spekulimeve. Analisti i njohur Abdi Baleta ka thënë se ata le të hidhërohen sa të duan dhe le të shqetësohen për "anadollakët turkoshakët halldupët robëruesit dhe aziatikët", por ata nuk mund të

ulin vlerat e fesë islame që ka shpëtuar pjesën më të madhe të popullit shqiptar nga asimilimi. Pavarësisht në se është përdorur dhunë apo jo, osmanët, duke sjellë fenë islame në Shqipëri, ata kanë bërë me të mirën. Askush nuk mund t'i shërbejë Shqipërisë e popullit shqiptar duke mbrojtur gënjeshtren, sepse pas rënies së komunizmit u botuan një numur shkrimesh që penalizojnë muslimanët dhe fenë e tyre hyjnore në mediat shqiptare si: "Rreziku i Shqipërisë nga fondamentalizmi islamik", "Përhapja e islamizmit me force e dhunë", "Shqipëria nuk do të jetë kurrë islamike", "Shqiptarët muslimanë janë pasardhësit e haremeve të Sulltanit", "Islami dhe militantët islamikë", "Muslimanët e tradhëtuan fenë, prandaj duhet të konvertohen në të krishterë". Shkrime të tilla i bëjnë presion lexuesit dhe në veçanti muslimanëve. Për Ben Blushin dhe për shumë Blushë të tjerë poeti i famshëm Gëte ka thënë: "Do të ishte mire të paktën për për ditë / një një këngë të vogël të ndëgjosh / një vjershë të bukur të lexosh / një pkturë të mire të shikosh / dhe në se është e mundur të bëhet / ndonjë fjalë me mend të thuash.

Bujar Shehu  
Shkodër, me 2 prill 2008

# FEJA NË SHOQËRINË BASHKOHORE

Për çfarë na duhet feja dhe si duhet ta kuptojmë atë në kontekstin e sotëm bashkëkohor?!... Këto janë dy pyetje që e kanë shqetësuar publikun e gjerë shqiptar gjerësisht pas viteve '50 të shekullit të kaluar dhe vazhdojnë ta shqetësojnë edhe sot. Në shekullin e kaluar këto pyetje nuk qenë aq të thjeshta sa ne po i paraqesim në këto rreshta, ato kushtuan jetë njerëzish dhe tortura e përndjekje pa fund. Megjithatë falë Zotit shqiptarët i kaluan ato 50 vjet të vështira, të cilat për jetët njerëzore të kësaj bote nuk janë pak, ndërsa për historinë përkthehen në tonelata dokumentesh. "Për çfarë na duhet feja?" u kthye në një pyetje retorike, me të cilën u mundua t'iu mbyllej goja njerëzve të thjeshtë dhe që pasojat e saj ishin tragjike jo vetëm për ato që i vuajtën në kurriz, por pasojat e saj ishin katastrofike edhe në lëmin shoqëror. "Feja është opium për popullin" dhe populli u la pa mjetet komunikuese dhe ndërlidhëse me të cilat sigurohet bashkëjetesa harmonike shoqërore. Pasojat e këtyre problemeve i ndejmë edhe sot kur njerëzit fillojnë të thonë "ne mendojmë kështu apo ashtu për fenë", duke harruar që ata nuk kanë ndonjë njohuri për atë qoftë edhe minimale. Nganjëherë vihet re edhe tek besimtarët që mundohen ta shpjegojnë fenë në mënyrë logjike pa pasur njohuritë e duhura se si mund të bëhet ajo. "Për çfarë na duhet feja?" sot! Për atë që i është dashur gjithmonë njerëzimit, për udhëzimin e mirë që mbart në vetvete. Feja jonë mirëmbahet në 5 shtyllat e saj, dëshmia, falja, agjërimi, zekati dhe haxhi. Shumë njerëz mundohen t'i shohin këto shtylla nga këndvështrimi i tyre personal dhe që në vetvete nuk ka ndonjë të keqe, kur mundohen t'i shërbejnë vetvetes. Kështu ato mund t'i

dëgjosh sesi e shpjegojnë faljen me lëvizjet dhe mirësitë që sjell kjo gjimnastikë e vazhdueshme. Agjërimin e shpjegojnë për mirësitë shëndetësore që sjell për shumë lloje sëmundjesh, për stomakun, zemrën, mushkëritë etj. Disa të tjerë e shpjegojnë ndalimin e ngrënies së mishit të derrit me atë që në Arabi klima është e nxehtë dhe ai ka shumë yndyrë, prandaj edhe u bë haram e shumë të tjera si këto mund të dëgjosh plot. Duke u marrë me kësi lloj argumentesh ato harrojnë atë kryesoren, se kjo fe ka mbi 1400 vjet që funksionon dhe në çastin e zbritjes së shpalljes hyjnore bota njerëzore ishte e zhytur në një errësirë të thellë shkencore dhe askush nuk e dinte se vuante nga hipertensioni, ulcera, gastriti, bronkopneumonia apo ndonjë sëmundje tjetër me emër latin. Kush mund t'i dinte atë kohë sëmundjet që mbart derri, apo leshmanjozën që është mbartës qeni, sëmundjet ngjitëse seksuale etj. Njerëzit nuk e morën Islamit në këtë rrugë. Ato e pranuan Islamit si fe e zbritur nga Zoti për të mirën e njerëzimit dhe e shfrytëzuan duke pasur parasysh këtë gjë. E ruajtën Kurandin dhe Traditën Profetike duke e shfrytëzuar si një kod moral të jashtëzakonshëm hyjnor dhe kështu ato e ndihmuan veten e tyre duke arritur në majat e shkencës dhe të moraleve e virtyteve njerëzore. Tashmë kjo është një gjë e vërtetuar historikisht. Në çastet kur ata e lanë të vështuarit në këtë mënyrë e dëmtuan veten dhe i dhanë lirinë jo të duhur vetes duke menduar në mënyrë të mbrapshtë dhe arritën në mesin e shekullit të kaluar ta ngrinin në normë të detyruar shtetërore dhe shoqërore njëkohësisht pyetjen retorike "Për çfarë na duhet feja?"!

Shqiptarët në kuadrin e një politike të gjerë globale të majtë zbatuan deri në ekstrem parrullën e njohur marksiste "Feja është opium për popullin". Akoma edhe sot e kësaj dite nuk dihet mirë se çfarë ndodhi në gjysëm-shekullin e kaluar dhe pritet të merret vesh nga hulumtimet e historianëve dhe të atyre dëshmitarëve që kanë mundur të mbeten gjallë. Citohe shifra, por me sa duket me një sy të parë, pa hyrë shumë në hollësi dëmi është më i madh nga ajo që duket. Edhe ato që nuk vuajtën drejtpërdrejt kanë pësuar nga ai mentalitet që u krijua nga regjimi komunist i Tiranës. Të gjithë po i vuajnë pasojat e asaj veprimtarie denigruese ndaj fesë, sepse shqiptarët në kontekstin bashkëkohor e kanë humbur mbështetjen kryesore; shoqërore dhe shpirtërore, ruajtësen e vlerave të pastra njerëzore: Islamit. Si duhet të sillemi dhe pse duhet të sillemi kështu asnjëri nga ne nuk di ta thotë dhe feja pa dyshim që do të kthehet në traditë të shkuar nga e cila mund të themi se agjërimi të bën mirë për shëndetin, falja është një gjimnastikë e mirë dhe përmbi të gjitha të hapim dyert për Bajram dhe të presim vizita e të bëjmë vizita të njëri-tjetri me një buzëqeshje fallco në fytyrë dhe me dy-tre kronika televizive e gazetareske që përcillen në këto ditë.

Islami është një fe që sjell kohezion shoqëror dhe është një fe hyjnore e pastër e zbritur nga vetë Allahu i Madhëruar për të mirën e njerëzimit dhe shqiptarët duhet ta marrin dhe ta shfrytëzojnë atë, meqë e panë dhe e provan mirë se si mund të përfundojë një shoqëri, e cila e kishte Islamit dhe e la atë.

Roald A. Hysa

## AHMET KOPLIKU - ATDHETAR I PAEPUR

Nderi, qe po i behet sot te ndjerit AHMET KOPLIKU, duke e shpallur "QYTETAR NDERI" te qytetit historik te Shkodres, eshte nje vulosje shum e drejte, qe i epet qendreses anti-komuniste, para dhe gjate shtypjes totalitare.

Kesaj shtypjeje te pa pare e te pa ndegjuar asnje here ne historine njerezore, i paten bere ball shqiptaret ne pergjithesi. Per kete, ata paten pesuar denimin e pa-merituar, nder burgje, nder fusha perqendrimi, nen tortura, te vecuar e te vetemuar, deri edhe me pak ose aspak buke, as me shtroje e mbuloje te duhur. Kane qene shum te ketij rangu, me qindera e me mijera...

Njeri nder 'ta ka qene edhe Ahmet Kopliku. Ai pa dashur, u-be deshmitar i mundimevet cnjerezore, i vuajtjevet te pa kufi nder kampe pune. Por si shum te tjere, ai ka dijtur te qendroje dhe me ballin lart, ia pat dalur me halle e me travaje, te mos perkulet, te mos e leshoje doret flamurin e anti-komunizmit. Dhe me ne fund, Ahmet Kopliku, si mbare populli shqiptar, doli fitimtar. Terrorizmi komunist ka marrur fund nje here e

mire! Shqiptaret e vete-dijshem kete kulsheder te mbrapshte do te dijne t'a shtypin sa here te paraqitet nevoja ose sa here t'a qesi kryet!!

Kjo eshte porosia, qe kane lene mbrapa Ahmet Kopliku me shoke!

Te nderuara Zonja e Zoterinje!

Duke e shpallur Ahmet Koplikun si "Qytetar Nderi" te Shkodres, kane nje merite te posacme edhe kryetari i Bashkise, Z. Lorenc Luka, kryetari i Keshillit Bashkiak, Z. Bardh Lohja siedhe kryetari i Ballit Kombetar Demokrat, Dega e Shkodres, Z. Xhemal Shqau, te cilevet u-shkojne falenderimet me te perzemerta!

Te njejtat falenderime te ndjeshme i shkojne edhe popullit shkodran, sepse keshtu i tregohet edhe armikut, se shqiptari don te jetoje me ndere, njashtu si jetoj edhe vete i ndjeri Ahmet Kopliku!

I perjeteshem qofte kujtimi i tije!!

Balli Kombetar – Komiteti per Diasporen (Kryesia)

### MUSLIMANI ME GABIME TE MEDHE E TE VOGLA

Në këtë botë të përkohshme  
Sado që të rrojmë  
Ngado që të shkojmë  
Vdekjes si shpëtojmë.

Të mëdha e të vogla gabime çdo ditë  
Me dashje e pa dashje  
Ne i kemi përsëritë.  
Por Allahu xh.sh. ata i ka ditë.

Gjithpërfshirja e tij  
Vërtet na mrekuillon  
N'hapësirë të tejskajshmë  
Ai na kontrollon.

Detyrë e kemi t' mos harrojmë  
Krijesat n' mes tokës dhe qiellit  
Nuk janë vepra jonë.  
Krijuesin e tyre mos t' harrojmë.

Pa rroba erdhëm, kështu do t,shkojmë  
Do t' vesim një ditë gjithmonë s' rrojmë.  
Qefinit ne s'i shpëtojmë.  
Por t' bardhë duhet ta meritojmë.

Vehbi Hoti

### SAHABET E RESULTIT (A.S.)

I lutem rinisë t'i njohin sahabijtë,  
Njohja e tyre pajisje me dritë.  
Yjet e Islamit sahabet e Resultit janë,  
Në dritën e Rrahmanit furnizimin kanë.  
Bukur mahnitëse në udhëzimin fener,  
Gjithmonë forcë shëtitëse s' perëndojnë ndonjëher.  
Ibadet dhe vepër kurrë nuk i ndanin,  
Tespithe Allahut me përvujtëni i banin.  
Në derë të Allahut të përvuejtun kërkuen,  
Botën materiale me iman sunduen.  
Në kohën e sahabeve yjtë të vegjël ishin,  
Që të ndiheshin të tillë për nder e kishin.  
Male, lugina...e rana në shkretinë,  
Në prani të sahabeve ndiheshin ma mirë.  
Prania e tyre dritë e madhështi,  
Të gjitha krijesat ua kishin lakmi.  
Sexhden e tyre e pritnin me padurim,  
Si n' shtratin e vdekjes i sëmuri kërkon shërim.  
Thirrja : "Allahu ekber"! , kalatë n' themel i tundte,  
Forcat e anmikut në zemër i shkundte.  
Se lidhjet me Allahun t' patundura ishin,  
Deri dhe melekët gati ju rrijshin.  
Ata ishin kandilat e jetës n' këtë botë,  
Pa dritën e tyre do t' ishte errësirë e plotë!  
Nuri i tyre nga Arrshi i Rrahmanit.  
Nxanës të Mustafas, përcuesi i Kur'anit.  
Kënaqësia e Allahut mbi ta qoftë gjithmonë,  
Në këtë botë dhe Ahiret, ata janë jehon.

Burhan FILI

# NGUTSHMËRIA ËSHTË NATYRË NJERËZORE

“Njeriu nga vet natyra e tij është i ngutshëm, e Unë do t’ua tregoj juve masen Time ndëshkuese, pra mos kërkonit t’u vijë më shpejt.”

Kur’ani, Suretu El Enbija, 37

Kushedi sa herë i kam lexuar këto rreshta Hyjnor! Sa herë kam medituar mbi ta! Sa përpjekje kam bërë për të reflektuar thellë mbi kuptimin Hyjnor dhe filozofik të këtij ajeti! Çdo herë kam menduar se

është e veshtirë të jepet kuptimi i vërtetë i këtij ajeti nga një gjykim njerëzor, duke qenë me origjinë Hyjnore.

Megjithatë duke gjykuar se mesazhi Hyjnor i ardhur nëpërmjet Kur’anit, i drejtohet njerëzimit, ne na jepet e drejta ta komentojmë atë ashtu siç e kuptojmë.

Gjithë ajo që mund të përputhet me të vërtetën Hyjnore e shkruar nga unë do të jetë frymëzim i ardhur nga Krijuesi dhe si i tillë do më sjellin kënaqësi shpirti që më orienton dhe më tregon se unë jam futur në Rrugën e Vërtetë të Zotit tim. Çdo gjë që nuk përputhet me Dijen Hyjnore, por unë e kam sjellë në këtë punim si të tillë, kërkoj nga Krijuesi të më fali gabimet dhe përgjegjësitë që kam marrë mbi vete dhe të më udhëzojë në Rrugën e Drejtë.

Njeriu u krijua në këtë jetë me Vullnetin dhe Urdhërin e Zotit të gjithësisë për një mision të madh : “ Të jetë zevendës i Zotit mbi tokë, të ndjekë dhe të zbatojë porositë Hyjnore, ta njohi Krijuesin e tij, ta adhurojë dhe t’i përulet Atij, të sigurojë vazhdimësinë e jetës mbi tokë, të njohë Jetën e Përtejme drejtë së cilës udhëtojmë.”

Njeriu u krijua nga dy fillesa të ndryshme, njera me origjinë Hyjnore “shpirti” dhe tjetra me origjinë njerëzore “trupi.” Shpirti, meqenëse është me origjinë Hyjnore, luan rolin kryesor në jetën e njeriut. Ai nuk është lëndë, nuk plaket, nuk ndikohet nga koha, pasi jeton jashtë kohës dhe e kundron atë nga jashtë. Ndërsa trupi i njeriut është lëndë, materie, sepse vjen nga toka dhe i kthehet përsëri asaj si një borxh i detyruar.

Ne nuk e dijme arsyen pse njeriu kur vjen në këtë jetë e fillon me lotë dhe përsëri në çastin që e kupton se po largohet nga kjo jetë, përfundon jetën e tij me lotë! Mos ndoshta shpirti i tij e ndjen se ardhja në jetën tokësore, urdhëruar nga Zoti i tij, që të jetë i lidhur pazgjydhshëmrisht me kurmin njerëzor, i krijon atij një obligim të veshtirë.

Meqenëse njeriu është i krijuar në tokë nga pjesë materiale, trupi i tij kërkon që të jetë i lidhur përjetësisht me token, ndaj, ai harron se bashkë me kurmin material ka edhe shpirtin e tij. Duke menduar se do të mbetet përjetësisht këtu mbi këtë tokë, ai harron se do të vijë një ditë jo e largët që do të ndahet përfundimisht nga kjo jetë materiale dhe mashtruese dhe se jeta e vërtetë, stabile, e njeriut është ajo shpirtërore, Jeta e Përtejme. Duke e menduar dhe arsyetuar gabim, njeriu është i ngutur në këtë gjykim, pasi harron se vdekja do t’i vijë njeriut para se ai ta mendojë. Njeriu është i ngutur në këtë jetë duke menduar se do t’i realizojë të gjitha planet, projektet, aspiratat, pikësynimet e tij, pa u kujtuar se prapa këtyre projekteve dhe nën këmbësorë e tij, qendron si një hije, vdekja që e pret nga çasti në çast. Ai shpesh nuk e mendon vdekjen dhe i duket se ajo nuk do të vijë kurrë, ndaj dhe hap pas hapi, ditë pas dite, vit pas viti deri në fund të jetës, njeriu aspiron për një jetë më të miirë. Kanë kaluar pesëdhjetë, gjashtëdhjetë, shtatëdhjetë vjet dhe ai përsëri ndërton projekte, jeton me shpresë. Vitet që kanë kaluar, i duken vetëm një çast dhe mendon se muajtë, ditët apo orët që i kanë mbetur si një e ardhme, janë gjithçka! Pra njeriu i ngutur në këtë jetë për t’i realizuar të gjitha kërkesat materiale, mirëqenien, lumturinë, harron se një ditë të gjitha këto do t’i lërë mbi këtë tokë, për të marrë me vete vepren e tij, e mirë apo e keqe qoftë ajo.

O njeri ! mos mendo se jeta materiale në këtë botë është çdo gjë, por kujto obligimet që Zoti të la! Në ajetin Kur’anor që unë përmenda në fillim të këtij punimi, Zoti xh.sh. na thotë : “.....Unë do t’ua tregoj juve masen Time ndëshkuese.....” Duke u nisur vetëm nga kjo pjesë e ajetit Kur’anor, njeriu duhet të mendojë dhe të reflektojë thellë mbi obligimet themelore që Zoti i ka ngarkuar njeriut, dhe çdo çast, ditën apo naten, në punë apo në pushim, në veprimtarinë e përditshme apo në krevat, të mendojë dhe të veprojë për t’i realizuar këto obligime.

Njeriu, nga vetë natyra e tij me një fillësë Hyjnore, “shpirtin”, është i prirur të dijë sa më shumë rreth botës që e rrethon. Ai duke reflektuar mbi universin, mbi gjithësinë dhe duke lexuar në shkenca, filozofi, dije e fe, ngutet kur mendon se i di të gjitha, se ai dijes i ka gjetë fundin. Por ai gabon shumë rëndë. Dija njerëzore është gjithmonë një dije e kufizuar. Sa më shumë që futemi në thellësi të dijes, aq më mirë shohim se ne dijme shumë pak nga të fshehtat e universit. Dija ngjanë me grykën e një pusi, ku në sipërfaqe çdo gjë na duket e qartë, pra ka dritë dhe sa më thellë të futemi në pus aq më errësirë ka. Gabojmë shumë po të mendojmë se dijme gjithçka dhe jemi të ngutur në gjykimin tonë. Me këto mendime ne vetëm gënjejmë veten tonë. Njeriu nuk duhet të ngutet asnjëherë në dhënie e një mendimi apo gjykimi, as në marrjen e vendimeve apo në kryerjen e veprimeve të ngutshme, pa i kaluar ato nëpër filtrin e gjykimin.

Meqenëse njeriu është i krijuar nga dy fillesa, ai përben një organizëm kompleks, një dualitet. Shpirti i njeriut, i ardhur nga Zoti, e orienton njeriun drejtë rrugës Hyjnore, pra ai ka gjithmonë një tërheqje pozitive, ndërsa trupi i njeriut i krijuar nga materia ka gjithmonë një tërheqje negative, drejtë tokës që e ka formuar. Natyra e tij materiale, si një tërheqje negative e njeriut, nuk duhet ta konkurojë asnjëherë natyrën e tij shpirtërore, që është një tërheqje pozitive që e çon njeriun në rrugën e Vërtetë.

Po ta mendojë njeriu mirë këtë, ai nuk do të ngutet asnjëherë në gjykimin e tij, por do të përmbushi obligimet ndaj Zotit të tij.

Unë si intelektual dhe si një mysliman i mirë po punoj me përkushtim për t’i përmbushur obligimet që kam ndaj Zotit tim, duke menduar në çdo çast se Zoti është shumë falës dhe mëshirues për njeriun që përpiqet të ecë në rrugën që ka caktuar për njerëzimin, në rrugën e Drejtë, në rrugën e Vërtetë. Në çdo çast unë kërkoj të jem nën mëshirën e Zotit tim. Atij i detyrohem! Atij i kërkoj ndihmë! Atij i jam mirënjohës dhe Atë e falnderoj që më fali gjenë më të çmuar, jetën dhe dijen për ta adhuroar dhe njohur Atë në vazhdimësi! Asnjë njeri të mos e mendojë se me punën dhe vepren e tij e siguron Jetën e Përtejme pa ndihmën dhe mëshirën e Zotit të tij.

Në librin e Rumi, poet dhe filozof i madh Iranian i shekullit XIII ka një tregim filozofik që ka lidhje me shpirtin e njeriut. Tregimi titullohet “Tregtari dhe papagali.” Rumi tregon : “Një tregtar posedonte një papagal të bukur dhe e mbante në kafaz. Një ditë tregtari u përgatit të shkonte në Indi. Para se të nisej tregtari, papagali i kërkoi pronarit të tij t’u dërgonte një mesazh papagajve të Indisë : -” Kur të arrish në Indi, bëju të ditur atyre gjendjen time e vetminë time, dëshiren time për t’i riparë. U thua që jam i burgosur në kafaz e që nuk mundem të fluturoj për t’i riparë miqtë e mi e për të kujtuar ditët e bukura që kemi kaluar së bashku.”

Tregtari i premtoi se do t’ua çonte mesazhin e tij papagajve të Indisë.

Kur tregtari mbërriti në pyjet e Indisë, pa aty papagajt dhe u dha atyre përshëndetjen, si dhe mesazhin e papagalit të tij. Me të dëgjuar mesazhin, njeri nga papagajt filloi të dridhej dhe pastaj ra si i vdekur. Pas tij ranë si të vdekur edhe papagajtë e tjerë. Tregtari

u hidhërua dhe u pendua për sa u kishte thënë atyre.

Kur u kthye në atdhe, i tregoi papagalit të tij se ç’i kish ndodhur në atë vend. Sapo mbaroi rëfimin e vet tregtari, papagali i tij përpoqi krahet dhe ra i vdekur nga kafazi, duke e habitur të zotin. I dëshpruar, nisi të ankohej për humbjen e papagalit. Megjithatë tregtari e nxori kufomen e papagalit dhe e hodhi jashtë. Papagali sapo u gjend jashtë kafazit, filloi të fluturojë.

Tregtari, i habitur, e pyeti papagalin t’i tregonte për sa kishte ndodhur dhe përse e gjithë kjo ngjarje e çuditshme!? Pyetjes së tregtarit, papagali iu përgjegj kështu : - Ju më sollët mesazhin kur treguat se çfarë u kishte ndodhur miqëve të mi në Indi. Për të qenë i lirë duhej të vdisja, ndaj dhe tani jam i lirë.”

Kuptimi filozofik i këtij tregimi është ky : Kafazi përfaqëson trupin e njeriut, i cili mban në robëri shpirtin. Shpirti i njeriut për të qenë i lirë duhet të shpëputet nga trupi dhe kjo arrihet vetëm pasi të vdesë njeriu. Pra njeriu për të kuptuar dashurinë Hyjnore, është e nevojshme të shpëputet nga lidhjet materiale. Duke pasur parasysh nevojat materiale të trupit të njeriut, shpirti si pjesë përbërëse dhe si dualitet i trupit mashtrohet nga ky dhe mbetet pothuajse skllav i tij. Besimtarit që mendon se një ditë do të dalë në Gjykimin e Madh, e ruan shpirtin e tij nga mashtrimi, por kjo nuk është e lehtë, kërkon sakrificë.

Njeriu duke qenë i ndertuar nga dy fillesa, nga ajo Hyjnore “shpirti” që tenton drejtë shenjtërimin të tij dhe i asaj tokësore “trupi” që tenton drejtë shejtanizimit, brenda tij, si dualitet, zhvillohet një luftë e ashpër, që çdo herë përfundon me fitoren e njerësisë dhe humbjen e tjetrës. Në këtë luftë shpesh fiton ajo materiale apo negative kundrejtë asaj pozitive shpirtërore. Në këtë rast njeriu është i ngutur pasi zgjedh atë që i largohet rrugës së Vërtetë

Në çdo kohë njeriu është aktor i historisë dhe i dramës së tij, të cilën e luan në skenë pa e ditur se çfarë zhvillohet pas kuintave, pa e ditur se cili ishte krijuesi i veprës që ai po luan në skenë. Njeriu nuk e di se nga erdhi në ekzistencë dhe për ku po udhëton! Por ai e di se është në udhëtim dhe se në këtë udhëtim ai gjithnjë është i ngutur.

Ne ngutemi kur themi : “...po, e di këtë!”, “...po e di edhe atë!” “...po di shumë nga ky apo ai fenomen...! Ne ngutemi si besimtar kur velloja e hipokrizisë na ka pushtuar qenien tonë. Ne jemi të ngutur shumë kur kohen e punës e pakësojmë dhe ia kalojmë adhurimit në dispozicion duke e kaluar 2,5 % të kohës ditë – natë njëzekatër orëshe. Nga Ligji Islam kemi mësuar se vetëm 2,5 % të kohës duhet ta kalojmë në adhurim, që është 36 minuta në 24 orë, dhe 2,5 % të pasurisë duhet të falim nga kjo pasuri. Koha është vlerë ashtu siç është edhe pasuria vlerë. Ajo që u hiqet këtyre vlerave për hir të Allahut është vetëm 2,5 % e tyre, Zoti është betuar në Kur’an : “ Pasha Kohën!” sepse nuk ka gjë më të shenjtë se koha. Të mos ngutemi duke pakësuar kohen e punës në favor të kohës së adhurimit sepse Zoti nuk e shikon si vepër të mirë këtë. Çdo njeri duhet të jetojë me djersën e tij.

Pesë shtyllat e Islamit janë obligim për çdo besimtar mysliman, por ne jemi të ngutur kur, të prirur pas interesave materiale, i harrojmë ato pjesërisht apo plotësisht.

Shpirti i njeriut i “kapur” si në kurth nga trupi i tij, është i detyruar t’u nënshtrohet interesave materiale pasi gjendet brenda një bote materiale. Me dëshirë apo pa dëshirë, i urdhëruar nga Zoti, ai pranoi të bëjë një jetë dualiteti me trupin e njeriut, por ai shpesh u mashtrua duke iu nënshtuar interesave materiale apo instikëve të tij.

Njeriu ka edhe obligime të tjera për t’iu afruar sa më afër Hyjnore, përveç pesë shtyllave Islame. Njeriu duhet të jetë i drejtë

gjatë jetës së tij, sepse e drejta buron nga Krijuesi i gjithësisë. Çdo herë që ne i largohemi kësaj rruge, jemi të ngutur në marrjen e vendimeve. Njeriu duhet të kërkojë vetëm të vërtetën, sepse ajo është rruga që çon drejtë njohjes së Krijuesit. Sa herë që njeriu i largohet kësaj rruge është i ngutur në marrjen e vendimeve të tij. Njeriu duhet të jetë i duruar gjatë jetës së tij, sepse durimi është veti Hyjnore, Sa herë që ne marrim vendime të shpejta dhe të ngutshme, pa i kaluar nëpër filtrin e durimit, gabojmë rëndë për veten tonë. Është më mirë të durosh dhe të mos e falish nemazin se sa ta falish nemazin e të mos kesh durim. Durimi si veti Hyjnore që është, ai është edhe pjekuri, është kulturë, është pjesa më e bukur që e kompletton njeriun.

Njeriu duhet të jetojë me djersën e tij, në të kundërtën ai është gjithmonë i ngutur në jetë.

Njeriu duhet të jetë i ndershëm në punë dhe në jetë, sepse ndershmeria është veti Hyjnore. Po u larguam nga kjo rrugë jemi të ngutur dhe të gabuar në jetë.

Njeriu nuk duhet të urrejë sepse urrejtja është rrugë e gabuar. Edhe këtu njeriu është i ngutur në gjykimin e tij për të urreyer dike për një arsye apo një tjetër. Zoti nuk mbolli mbi tokë urrejtjen por dashurinë për krijesat e tij. Nuk ka virtyt më të lartë se sa dashuria. Ajo siguron vazhdimësinë e jetës mbi tokë.

Njeriu nuk duhet asnjëherë të krijojë ngatrrësë me një njeri tjetër, kushdo qoftë ky, pasi krijimi i ngatrrësës, i sherrit të çon gjithmonë në rrugë të gabuar. Këtu do t’i referohem Sadiut, poet i madh Persian, I cili thoshte :

“.....Dy të urtë se këpusin një fillë pe Shkëmb n’u bëftë njeri tjetri bëhet dhe’ Por në qofshin të dy me brirë,

Tërhiq tërhiq këpusin zinxhirë.....”

Njeriu nuk duhet asnjëherë të bëjë padrejtësi, të dhunojë, të shtypë të tjerët, të përfitojë padrejtësisht etj, sepse të gjitha këto janë të denueshme dhe rrugë të gabuara që na bëjnë të ngutemi ne marrjen e vendimeve tona.

Nuk do të ndalem më shumë për të dhënë shembuj që njeriu është i ngutur në këtë jetë, pasi ka shembuj të shumtë, por do të reflektoj në atë që njeriu duke i dhënë përparësi anës materiale gabon rëndë dhe është i ngutur në gjykimin dhe në marrjen e vendimeve duke harruar pjesën më të rëndësishme, atë Hyjnore, duke mos menduar se çfarë e pret në Jetën e Përtejme, të paralajmëruar nga Allahu në ajetin Kur’anor të cituar në fillim të këtij artikulli : “.....Unë do t’ua tregoj juve masen Time ndëshkuese.....”

O njeri ! Kurrë mos u ngut në gjykimin dhe veprimet tuaja në jetë sepse në të kundërtën do të jesh në rrugën e gabuar !

Fjala “ njeri ” përbëhet nga dy pjesë : pjesa e parë “nje-” dhe pjesa e dytë “- ri.” Ndoshta jam i gabuar në gjykimin tim, dhe për këtë i kërkoj falje Allahut, por unë e gjykoj se njeriu i krijuar si një dualitet, pra nga shpirti dhe trupi, ka një kuptim Hyjnor përbërja e tij.

Pjesa “Nje -”, pra prezenca e “Njëshit” në krijimin e tij duke i futur shpirtin që është i përjetshëm; dhe “- ri”, ribërjen, pra krijimin. Duke marrë pjesën materiale për ta bashkuar me shpirtin në një individualitet i cili përbën një harmoni, një unitet dhe në të njëjten kohë brenda këtij uniteti zhvillohet një luftë e vazhdueshme gjatë gjithë jetës, ku fitorja e njëres apo tjetrës pjesë, i krijon mundësinë njeriut për të zgjedhur rrugën Hyjnore apo atë të djallit dhe për secilen ka shpërblimin ose ndëshkimin e tij. Në çdo hap të jetës njeriu ka vend për t’u korriguar duke i dhënë përparësi shpirtit e jo trupit. Pra të përgatitemi për atë që na ka premtuar Zoti ynë, për Jetën e Përtejme!

Nga Riza Spahija

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ  
BISMIL-LAHIRR-RAHMANIRR-RAHIME

Tregtojme  
**MISH  
HALLALL**

E XHUMA  
PUSHIM

BESNIK ALUSHI  
ISMETI

TURISTIKE  
TRAVEL  
0250370  
0157200

**Produkte Hallall**

**KLIENTË TË NDERUAR!  
VËLLEZËR DHE MOTRA MUSLIMANË,  
MARKET "ISMETI" JU GARANTON**

**1- Produkte mishi hallall si:  
sallam, suxhuk etj.  
2- Piceri hallall  
3- Fast Food hallall**

**Ju keni të drejtë të blini ku të doni  
por hallalli i vërtetë është vetëm  
tek market "ISMETI"**

Adresa: Pranë teatrit "MIGJENTI"  
Cel: 0692101893

**EJANI TEK NE! FABRIKA E PERPUNIMIT  
TE DRURIT**

**ILIRIA**

me pronar Haxhij Ilir Muja (aktivist dhe  
bamiresh Islam), ju afrohem prodhime nga  
me" të thjeshtat deri ne dhoma gjumi.  
Shërbehet ne kohe dhe me cilësi të  
larte:

Prodhim dyer e dritare

Dhoma gjumi

Pajisje zyrash

Pajisje kuzhine

Dhoma fëmijësh

Pajisje për ambiente lokale

Te gjitha këto me çmime konkurruese  
dhe me transport të garantuar falas.  
Ejani në fabrikën tone dhe do te mbeteni  
te kënaqur. Mund te kontaktoni me  
numrin e mobilit: 0692523565

